

Termet e Referencës

Trajner/e për zhvillimin dhe mbajtjen e një trajnimi dy-ditor me stafin e organizatës mbi Menaxhimin e Ciklit të Projektit

I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuar përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS synon të angazhojë një trajner/e për zhvillimin dhe mbajtjen e një **trajnimi dy-ditor** me stafin e organizatës mbi **Menaxhimin e Ciklit të Projektit**. Qëllimi i këtij angazhimi është forcimi i kapaciteteve të stafit për të planifikuar, zbatuar, monitoruar dhe vlerësuar projekte në mënyrë të strukturuar, efikase dhe të qëndrueshme, në përputhje me standardet bashkëkohore dhe praktikatat e mira të menaxhimit të projektit.

Përmes këtij trajnimi synohet:

- Të forcohen njohuritë mbi konceptet bazë dhe fazat e Menaxhimit të Ciklit të Projektit;
- Të përvetësohen aftësi praktike për analizën e problemeve, aktorëve dhe objektivave;
- Të zhvillohen kapacitete për hartimin e logframe-it, përfshirë indikatorët, burimet, supozimet dhe mjetet e verifikimit;
- Të përmirësohet planifikimi i aktiviteteve, buxhetit dhe menaxhimi i riskut;
- Të kuptohet rëndësia e monitorimit dhe vlerësimit si pjesë përbërëse e ciklit të projektit;
- Të nxitet zbatimi i qasjeve gjithëpërfshirëse, pjesëmarrëse dhe të bazuara në të drejta, në planifikimin dhe implementimin e projekteve.

IV. KUALIFIKIMI

- Përvojë në trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile, me fokus në menaxhimin e projekteve;
- Diplomë universitare në menaxhim projektsh, ekonomi , ose fusha të ngjashme;
- Aftësi të prezantimit, udhëheqjes së trajnimeve dhe përdorimit të metodave interaktive gjatë trajnimeve;
- Njohuri të shkëlqyera në përdorimin e mjeteve të menaxhimit të projekteve (p.sh. logframe, gantt chart, risk analysis, etj.);
- Përvojë e dëshmuar në menaxhimin e ciklit të projektit, përfshirë planifikimin, implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e projekteve.

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Trajneri/ja do të jetë përgjegjës/e për:

- Të zhvillojë një plan pune dhe agjendë për trajnimin në bashkëpunim me ekipin e HANDIKOS;
- Të përgatisë materialet e trajnimit, përfshirë prezantime dhe ushtrime praktike;
- Të mbajë trajnimin dy-ditor për stafin e HANDIKOS mbi Menaxhimin e Ciklit të Projektit, duke përfshirë:
 - Planifikimin dhe analizën e projekteve;
 - Hartimin e logframe-it dhe përcaktimin e indikatorëve;
 - Buxhetimin dhe planin e aktiviteteve;
 - Monitorimin dhe vlerësimin e projekteve;
- Të sigurojë që trajnimi të jetë praktik, gjithëpërfshirës dhe i përshtatur me përvojën e pjesëmarrësve;
- Të zhvillojë një vlerësim para dhe pas trajnimit për të matur nivelin e njohurive;
- Të përgatisë një raport përfundimtar me përmbledhje të procesit të trajnimit, pjesëmarrjes, rezultateve dhe rekomandimeve për përmirësim të mëtejshëm.

VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Qershor 2025 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Parapërgatitja e trajnimit dhe materialeve	2 ditë
Fasilitimi i trajnimit mbi Ciklin e menaxhimit të projekteve me stafin e HANDIKOS	2 ditë
Përgatitja e raportit final	2 ditë

Totali i ditëve	6 ditë
------------------------	---------------

VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të leshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit me sukses të trajnimit dhe dorëzimit të dokumentit final të aprovuar nga HANDIKOS.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Metodologjia e punës për këtë angazhim(max. 3 faqe);
- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Propozimi financiar
- Certifikata si: PMP/PMI, PRINCE2, CAPM, Agile or Scrum (kanë përparësi, por jo obligative)

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org dhe antika.maksutaj@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për “Trajner/e për zhvillimin dhe mbajtjen e një trajnimi dy-ditor me stafin e organizatës mbi Menaxhimin e Ciklit të Projektit”

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacionit është 23 Qershor 2025, ora 17:00.

Vetëm kandidatët e suksesshëm do të kontaktohen!

Pas përzgjedhjes Eksperti/ja i përzgjedhur duhet të dërgojë:

- **Dokumentin/ Dëshminë që nuk jeni nën hetime.**
- Poashtu duhet të nënshkruaj **Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve si dhe Rregulloren mbi Parandalimin e Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual — PSHAS** dhe t'u përmbahen kushteve dhe kriterëve të tyre.